DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
-VI- Nr. Br. No. 0204-595/5
Data Datum Date 30.04.2015

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

## Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

*Prishtinë, Datë:29.04.2015*
*Nr.0204-595/3*

**Për: Haxhi Ibishi,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Klinës

**Lënda:** Shkresë përcjellëse

I nderuar,
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar, **Vendimin për miratimin e Draft-Planit Lokal të Veprimit për Rini 2015-2016,** i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Klinës dhe nënshkruar nga Kryesuesi i KK të Klinës, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Në bazë të Vendimit të Qeverisë me Nr. 2/119 të datës 07.04.2010 për formimin e komisioneve për shqyrtimin e akteve lokale, MAPL, me shkresë përcjellëse të datës 10.04.2015, ka përcjellë aktin e lartshënuar te komisioni i përbashkët MKRS/MAPL, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni Raportin lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit të lartshënuar të Komunës së Klinës.

Me respekt,
**Besnik Osmani,**
Sekretar i Përgjithshëm,

*Kopje: Kryetarit të Komunës së Klinës,*
*Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave*
*Arkivit të MAPL-së*

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports
Ref.Nr. 1638/2015
Data 28.04.2015
Nënshkrimi

PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISHTINA - INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration
Data: 28.04.2015
VI-0204-595/3

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

***Ministria e Kulturës,Rinisë dhe Sportit***

***Ministarstvo Kulturu, Omladine i Sport - Ministry of Culture ,Youth and Sports***

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 22.04.2015 |
| **REFERENC-Ë:** | 13/2015 |
| **PËR/ZA/TO:** | Z. Besnik OSMANI, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL |
| **CC:** | |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | Z. Veton FIRZI,Sekretar i Përgjithshëm në MKRS |
| **NGA/OD/FROM:** | Feim Hoxha, Kryesues i Komisionit Ndërqeveritar për mbikëqyrjen e ligjshmërisë se akteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit të nxjerra nga Komunat |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Konfirmim i ligjshmërisë lidhur me Vendimin e Draft-Planit Lokal të Veprimit për Rini 2015-2016 të miratuar nga Kuvendi Komunal i Klinës. |

I nderuar Sekretar,

Komisioni i përbashkët i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ( MKRS ) dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02-119 të datës 07.04.2010, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave për kompetenca vetanake dhe për kompetencat të deleguara, si dhe mbështetur në Rregulloren Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, me datë 08.04.2015 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë Vendimin e Draft-Planit Lokal të Veprimit për Rini 2015-2016 të miratuar nga Kuvendi Komunal i Klinës.

Komisioni pas vlerësimit të ligjshmërisë lidhur me Vendimin e miratuar për Draft-Planit Lokal të Veprimit për Rini 2015-2016 nga Kuvendi Komunal i Klinës, ka konstatuar se vendimi është në harmoni më legjislacionin në fuqi .

Feim Hoxha, Kryesues i Komisionit Ndërqeveritar

Kamuran GORANCI, Anëtarë/MKRS

Ibër ALAJ, Anëtarë/MKRS

Xhevat BAJRAMI, Anëtarë/MKRS

Lumnije AZEMI, Anëtare/MAPL

Me respekt,